



SHQIPËRI: Deklaratë përmblylëse e ekipit për Misionin e Nenit IV për vitin 2018

20 nëntor 2018

Deklarata përmblylëse përshkruan konstatimet paraprake të ekipit të FMN-së në mbyllje të një vizite nga një ekip zyrtar (ose “misioni”), në shumicën e rasteve në një shtet anëtar. Misionet kryhen si pjesë e konsultimeve të rregullta (zakonisht vjetore) në bazë të Nenit IV të Statutit të FMN-së, në kuadër të një kërkesë për të përdorur burimet e FMN-së (hua nga FMN), si pjesë e diskutimeve të programeve të monitoruara nga ekipi ose si pjesë e monitorimeve të tjera që u bën ekipi zhvillimeve ekonomike.

Autoritetet kanë dhënë pëlqimin për publikimin e kësaj deklarate. Pikëpamjet e shprehura në këtë deklaratë janë të punonjësve të FMN-së dhe nuk përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e Bordit Ekzekutiv të FMN-së. Mbështetur në konstatimet paraprake të këtij misioni, ekipi do të përgatisë një raport i cili, në varësi të aprovimit nga instancat drejtuese, do t'i paraqitet Bordit Ekzekutiv të FMN-së për diskutim dhe vendimmarrje.

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën drejtimin e zotit Jan Kees Martijn, vizitoi Tiranën gjatë periudhës 6-20 nëntor 2018, për diskutimet konsultuese vjetore sipas Nenit IV. Në përfundim të vizitës, misioni doli me këtë deklaratë:

Rritja ekonomike e Shqipërisë ka ndjekur prirjen rritëse vitet e fundit, ndërkohë që vendi ka përfituar nga reformat e zbatuara dhe nga zgjerimi ekonomik i partnerëve të saj tregtarë europianë. Në të njëjtën kohë, mbetet shumë për të bërë që rritja ekonomike të jetë më e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe që të dobësojë shtysat për emigracion. Është po ashtu e rëndësishme të vendosen amortizues më të fuqishëm, sidomos tani që janë rritur risqet ndaj së ardhmes ekonomike të Evropës. Në reformat kyçe përfshihet fuqizimi i shtetit ligjor dhe institucioneve ekonomike, heqja e pengesave ndaj rritjes së investimeve dhe kursimeve private dhe zvogëlimi i borxhit publik me ritëm më të shpejtë nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të investimeve publike dhe zgjerimit të bazës së të ardhurave fiskale. Gjithashtu, ruajtja e stabilitetit financiar ndërkohë që arkitektura e sektorit bankar është duke ndryshuar e rrit kompleksitetin e mbikqyrjes financiare. Përparimi në këto fronte do ta ndihmonte Shqipërinë edhe në ecjen e saj përpara drejt integritit në Bashkimin Europian.

Një perspektivë më së shumti pozitive

Një shtytje e përkohshme prej prodhimit të energjisë elektrike falë kushteve të favorshme të motit pritet ta çojë shkallën e rritjes ekonomike në 4 për qind këtë vit, e cila pritet të

ngadalësohet disi në 3,7 për qind në vitin 2019. Në periudhën afatmesme, parashikojmë që shkalla e rritjes të jetë rreth nivelit 4 për qind, e mbështetur nga rritja e eksporteve, përfshirë turizmin dhe investimet në infrastrukturë. Kursi i këmbimit është mbiçmuar ndjeshëm pas muajit mars, duke ushtruar presion rënës mbi inflacionin, i cili pritet të rritet shumë gradualisht, për të arritur objektivin prej 3 për qind brenda vitit 2021. Në tetor, autoritetet emetuan me sukses Eurobondin prej 500 milion euro, me afat shtatëvjeçar, me normë të favorshme interesi prej 3,5 për qind. Me përfundimin e projekteve të mëdha energjetike që kanë komponentë të mëdha importesh, parashikojmë që deficiëti i llogarisë korente të ngushtohet në rreth 6 për qind të PBB-së përgjatë periudhës afatmesme. Megjithëse sistemi bankar është i kapitalizuar mirë dhe likuid, kredidhënia në mbështetje të investimeve të biznesit mbetet e dobët. Kreditë nën standard kanë rënë me më shumë se 10 pikë përqindje që prej vitit 2014, por në disa banka mbeten të larta.

Por risqet anojnë për nga ana rënëse. Shqipëria është e ekspozuar fort ndaj risqeve në rritje në Europë, përfshirë partnerët e saj kryesorë tregtarë. Një ngadalësim në këto vende, do të kishte ndikim edhe në Shqipëri nëpërmjet rënies së eksporteve, dërgesave të emigrantëve dhe investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD). Gjithashtu, shtrëngimi i pritur në kushtet financiare botërore do ta rriste koston e financimit të Shqipërisë. Krahas këtyre, ka edhe risqe të rëndësishme të brendshme. Duke vështuar përpara, nëse përparimi në reformat strukturore, përfshirë menaxhimin e financave publike, sektorin energjetik dhe sistemin gjyqësor është i pamjaftueshëm, mund ta zbehë besimin dhe ta vonojnë konvergjençën me vendet e tjera të rajonit. Kushtet e këqija të motit mund ta çënonin prodhimin e energjisë elektrike, duke krijuar kështu risqe ndaj buxhetit.

Kufizimi i risqeve fiskale dhe përmirësimi i cilësisë së të mirave publike

Konsolidimi fiskal duhet përshpejtuar. Nevojitet zvogëlimi i deficiëtit fiskal për të krijuar amortizues fiskalë. Nëse risqet që pengojnë rritjen ekonomike do të realizoheshin në periudhën e afërt, hapësira për stimul fiskal do të ishte shumë e kufizuar. Parashikojmë se, në mungesë të masave të tjera shtesë, deficiëti i qeverisë do të vijojë të jetë pranë nivelit 2 për qind të PBB-së në 2018 dhe më tej, çka do të rezultojë në një trajktore rënëse të borxhit publik, ndonëse me një reduktim më të ngadaltë se sa ne do të rekomandonim, në 62,3 për qind të PBB-së brenda vitit 2021 (përfshirë këtu edhe niveli i parashikuar i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme prej rreth 0,6 për qind të PBB-së). Kjo trajktore supozon mbajtjen e një niveli likuiditeti të arsyeshëm si rezervë në llogarinë unike të thesarit, të barabartë me 1 për qind të PBB-së. Për të arritur objektivin e autoriteteve për uljen e borxhit publik në nivelin 60 për qind të PBB-së brenda vitit 2021 në mënyrë të qëndrueshme, do të nevojiten korrigjime të mëtejshme fiskale. Mosarritja e këtij objekti do të çënonte besimin e tregjeve financiare. Për vitin 2019, do të këshillojmë një zvogëlim të mëtejshëm të deficiëtit me më shumë se 0,5 për qind të PBB-së, çka mund të arrihet nëpërmjet një

kombinimi të indeksimit të normës së akcizës, taksave mjedisore dhe zgjerimit të mëtejshëm të bazës tatimore.

Fuqizimi i rregullit fiskal do ta mbështeste konsolidimin dhe besueshmërinë e kuadrit fiskal në periudhën më afatgjatë. Rekomandojmë vendosjen e objektivave sasiore për bilancin fiskal vjetor (primar ose total), si bazë mbështetëse për objektivin e uljes së borxhit në jo më shumë se 45 për qind të PBB-së.

Duke pasur parasysh mungesën e hapësirës fiskale, i nxisim fort autoritetet të mos shtojnë ulje, përjashtime apo trajtime preferenciale tatimore *ad hoc* dhe të konsiderojnë anulimin e atyre të miratuara tashmë. Ato e bëjnë më të komplikuar dhe më pak të parashikueshëm sistemin tatimor, çka cënon, si klimën e investimeve, ashtu edhe mbledhjen e tatimeve. Në të njëjtën kohë, masat e marra për fuqizimin e cilësisë së administrimit të të ardhurave fiskale po bëjnë progres përfshirë dhe nëpërmjet një sistemi të ri për integrimin e të dhënave që po instalohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Gjithashtu, e mirëpresim progresin e reformës së taksës mbi pasurinë e paluajtshme dhe fillimin e pritur të kadastrës fiskale në janar 2019. Fuqizimi i mëtejshëm i bazës së të dhënave dhe i metodikave të vlerësimit do të jenë të rëndësishme për ta rritur transparencën dhe për ta mbështetur vënien në zbatim të këtij sistemi nga autoritetet tatimore vendore.

Në anën e shpenzimeve, puna për rritjen e efikasitetit nuk duhet ta ulë nivelin e shpenzimeve buxhetore në fushat prioritare. Nevoja për të përmirësuar arsimin, kujdesin shëndetësor dhe infrastrukturën drejt standardeve europiane kërkon rritjen e cilësisë dhe nivelit të shpenzimeve. Në veçanti, shpenzimet për arsimin mbeten në nivel të ulët, ndërkohë që mungesat e krahut të aftë të punës përbëjnë kufizim serioz mbi produktivitetin dhe rritjen.

Rritja e shpejtë e partneriteteve publike private (PPP) i ka rritur risqet fiskale, çka kërkon përmirësime të tjera shtesë në kuadrin për investimet publike. Është thelbësore të fuqizohet planifikimi dhe realizimi i investimeve në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë qeverisjen vendore dhe qendrore, si edhe ndërmarrjet shtetërore, dhe të shumëfishohen përpjekjet në drejtim të arritjes së maksimizimit të vlerës. Brenda investimeve publike, stoku i PPP-ve është duke u zgjeruar. Relacioni i buxhetit 2019, përveç stokut aktual të PPP-ve prej 31 për qind të PBB-së (nga të cilat rreth 23 për qind të PBB-së koncesione në sektorin e energjisë), paraqet projekte potenciale PPP-sh të kufizuara në 15 pikë përqindje. I mirëpresim përpjekjet për ta fuqizuar rolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si filtër për të mbajtur nën kontroll koston e mundshme fiskale të PPP-ve. Krahas kësaj, këshillojmë nxitjen e një procesi me oferta konkurruese duke mos pranuar më propozime të pakërkua për PPP-të. Ndonëse shpenzimet e parashikuara për PPP-të mbeten poshtë tavanit ligjor prej 5 për qind të të ardhurave tatimore, kjo lë pak hapësirë për projekte të tjera PPP-sh me fonde shtetërore.

Rritja e detyrimeve të prapambetura buxhetore që nga 2016 duhet të trajtohet pa vonësë. Detyrimet e prapambetura, përfshirë ato të pushtetit vendor, çmohen se janë sa 1,5 për qind e PBB-së në fund të muajit shtator 2018. Parandalimi dhe mbajtja e tyre nën kontroll kërkojnë fuqizim të parashikimit të të ardhurave dhe menaxhimit të likuiditetit dhe përmirësim të sistemeve të kontrollit mbi angazhimet, sidomos nga ARRSH-ja. Rimbursimi në kohë i tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) është me rëndësi për të krijuar besim të administratave tatimore dhe të funksionimi i sistemit të TVSH-së.

Përfshirja e vlerësimit të risqeve fiskale në buxhetet e fundit është e mirëpritur, por duhet rritur më tej thellësia dhe mbulimi i dokumentit të botuar. Kjo do të duhej të përfshinte zgjerimin e analizës për të përfshirë një gamë më të gjerë të risqeve për bilancin e sektorit publik përfshirë ndër të tjera një analizë më të hollësishme të detyrimeve të kushtëzuara, përfshirë ato që janë pjesë e kontratave të PPP-ve. Vlerësimi duhet të prezantojë edhe masa për adresimin e rreziqeve të mundshme, për të rritur besueshmërinë e vlerësimeve buxhetore.

Të zbatohen me vendosmëri reformat e planifikuara për ta bërë sektorin energjetik të qëndrueshëm nga ana financiare. Reformat, nën orientimin e planit pesëvjeçar të rimëkëmbjes financiare, i përgatitur me mbështetjen e Bankës Botërore, parashikojnë shlyerjen e borxheve të prapambetura, zvogëlimin e mëtejshëm të humbjeve të shpërndarjes dhe një orientim më të mirë të investimeve. Përfundimi i procesit të reformave kërkon edhe marrjen në kohë të vendimeve për strukturën e drejtimit të brendshëm të shoqërive publike në sektorin energjetik, vendosjen e çmimit (në të gjithë zinxhirin e prodhimit) që siguron mbulimin e kostos dhe për fondet rezervë të nevojshme në rast thatësire.

Bërja e politikës monetare më efektive

Qëndrimi aktual akomodues i politikës monetare mbetet i përshtatshëm derisa inflacioni t'i afrohet objektivit, por efektiviteti i politikës zbehet nga pengesa strukturore. Megjithëse ulja e normës bazë në një minimum historik është përcjellë në tregjet financiare, efekti rritës mbi inflacionin mbetet për t'u parë. Transmetimi i politikës monetare kufizohet nga përdorimi i gjerë i euros dhe parasë në dorë (në vend të depozitave në lekë) dhe dobësitë strukturore në kreditim, përfshirë vijimin e nivelit të lartë të kredive nën standard, dobësitë tek të drejtat e pronësisë dhe nën regjimin e falimentit, nivelin e lartë të informalitetit, tkurrjen e levës financiare të bankave dhe mungesën e dëshirës për të ndërmarrë risk. Trajtimi i këtyre pengesave do ta mbështeste rritjen e kreditimit dhe krijimin e parasë dhe do të përmirësonte transmetimin e politikës monetare.

Brenda regjimit fleksibël të kursit të këmbimit të Shqipërisë, autoritetet kanë ndërhyrë për të zbutur presionet e forta mbiçmuese të kohëve të fundit. Prej muajit qershor 2018,

Banka e Shqipërisë (BSH) ka kryer ndërhyrje të paplanifikuara në tregun valutor në përgjigje të mbiçmimit të fortë të monedhës vendase. Këto blerje janë përqendruar në parandalimin e kushteve të çrregullta të tregut dhe në zbutjen e efekteve rënëse në inflacion, brenda mandatit të Bankës së Shqipërisë për mbajtjen e inflacionit brenda objektivit. Sa i takon së ardhmes, i nxisim autoritetet t' i ndërpresin gradualisht këto operacione me zbutjen e riskut për disinflacion; fleksibiliteti i kursit të këmbimit e ka ndihmuar Shqipërinë, duke zbutur ndikimin e tronditjeve në ekonomi.

Një sistem financiar më i fortë

Panorama financiare e Shqipërisë po ndryshon: rënia e nivelit të kredive nën standard duhet të vendosë kushtet e nevojshme për rritjen e kreditimit, ndërsa bankat që nuk vijnë nga Bashkimi Evropian po luajnë një rol në rritje. BSH-ja vazhdon ta përmirësojë kuadrin e saj mbikëqyrës dhe rregullator, por ka ende elemente që shkaktojnë cënueshmëri.

- *Zvogëlimi i kredive nën standard.* Qasja e autoriteteve ka pasur rezultat në zvogëlimin e raportit të kredive nën standard, sidomos nëpërmjet shuarjes nga bilanci. Një zvogëlim i mëtejshëm kërkon: (i) zbatimin e ligjit të ri të falimentit, (ii) miratimin e kuadrin rregullator për marrëveshjet e zgjidhjes jashtëgjyqësore të kredive të këqija, (iii) zgjidhjen e ngërçit lidhur me funksionimin më efikas të përmbaruesve privatë dhe (iv) përshtetimin më tej të shuarjes së kredive nën standard.
- *Mbështetja e cilësisë së sistemit bankar.* Filialet e bankave nga Bashkimi Evropian kanë luajtur një rol të rëndësishëm në vendosjen e standardeve për bankat në Shqipëri. Ndërkohë që pronësia e bankave po u kalon grupimeve vendase dhe nga vende jo të Bashkimit Evropian, mbikëqyrja bankare ka një rol shumë të rëndësishëm për të mbajtur nën kontroll risqet që rrjedhin nga kreditimi i palëve të lidhura, kreditimi ndërkuftar dhe ekspozimet e mëdha. Për t' u bërë ballë këtyre sfidave, si dhe standardeve të reja të Bazelit, është e rëndësishme që Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë të ketë personel të mjaftueshëm për të kryer kontrole në vend më të shpeshta të bankave që paraqesin risqe më të larta.
- *Zhvillimi i tregjeve financiare.* Një treg funksional për instrumentet e borxhit shtetëror siguron bazën për zhvillimin e instrumenteve të tjerë financiare. Nxiten fuqimisht autoritetet të angazhohen për një emetim të parashikueshëm të bonove afatshkurtra të thesarit dhe për të balancuar uljen e kostove të shërbimit të borxhit me fokusin tek zhvillimi i tregjeve vendase të kapitalit. Gjithashtu, zhvillimi i skemave të pensionit privat të shtyllës së dytë dhe të tretë do ta përmirësonin sistemin e mbrojtjes sociale nëpërmjet instrumenteve të reja të kursimeve. Me zhvillimin e mëtejshëm të

tregut, do të duhej të rriteshin njohuritë financiare për të zbutur risqet dhe për të nxitur gjithëpërfshirjen financiare.

- *Strategjia për de-euroizimin:* Zbatimi në muajin korrik i një niveli të diferencuar të rezervës së detyrueshme për depozitat në valutë të huaj ishte një hap i dobishëm, në përputhje me planin për de-euroizimin. Si një fazë e dytë, do të ishte e dobishme për autoritetet përgatitja e veprimeve specifike për të dekurajuar vendosjen e çmimeve dhe kryerjen e pagesave në valutë të huaj në transaksionet vendase.
- *Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.* Hapa të vazhdueshëm për të forcuar kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit janë të nevojshëm për të adresuar dobësitë dhe për të ruajtur paprekshmërinë e sistemit financiar të Shqipërisë.

Përmirësimi më tej i klimës së biznesit dhe shtetit ligjor

Nevojiten përpjekje të vendosura për ta përmirësuar klimën e biznesit që të nxitet një rritje më e shpejtë dhe më gjithëpërfshirëse si dhe integrim më i fortë rajonal, në mënyrë që të dobësohen shtysat për të emigruar. Në këtë kuadër, prioritetet përfshijnë (i) zbatimin me vendosmëri të reformës në sektorin gjyqësor, forcimin e shtetit ligjor dhe zbatimin e strategjisë anti-korrupsion; (ii) fuqizimin e kuadrit për të drejtën e pronës dhe detyrimeve kontraktore për të nxitur kreditimin e sektorit privat dhe thithjen e IHD-ve; (iii) përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe arsimit, që ka rëndësi të madhe për t'i dhënë zgjidhje mungesës në rritje të fuqisë punëtore të kualifikuar; (iv) ngushtimin e dallimeve në infrastrukturë me vendet e tjera të rajonit; dhe (v) harmonizimin e rregullave dhe standardeve me BE-në për të nxitur pjesëmarrjen në zinxhirët botërorë të vlerave.

Ekipi i FMN-së dëshiron të falënderojë autoritetet dhe bashkëbiseduesit e tjerë për bashkëpunimin e frytshëm dhe mikpritjen.